

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6493  
E martë, 21 dhjetor 2021  
çmimi 0.40 €

Gjykata Speciale  
mbyll punimet deri  
më 7 janar FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## KËRKOHEM HEQJA E ORËS POLICORE



Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, kanë kërkuar nga qeveria heqjen e orës policore për festat e fundvitit. Drejtori ekzekutiv i AKK-së, Sazan Ibrahim, dhe i pari i AAK-së, kanë thënë se nuk ka asnjë argument shkencor i cili tregon se kjo masë ndihmon në luftimin e përhapjes së pandemisë Covid-19. Sipas tyre, ndalimi i qarkullimit do të jetë një pengesë për diasporën që do të vijë për festat e fundvitit në Kosovë

### AKTUALE

**A HOTBED OF CLOAK-AND-DAGGER SKULLDUGGERY IN THE HAGUE** F. 8



**ERELI: GJYKATA SPECIALE PO DËSHTON DHE ËSHTË KOMPROMETUAR** F. 9

### OPINION

**"BALLKANI I HAPUR", ME SHUMË PIKËPYETJE TË REJA** F. 7



Milazim  
KRASNIQI

### AKTUALE

**RRITEN PREJ 220-PËRQINDËSH TË HYRAT NGA PAGESAT UJORE** F. 5

**ARRIHET MARRËVESHJA, KOSOVA I JEP DANIMARKËS NË SHFRYTËZIM 300 QELI BURGU** F. 5

### EKONOMI

**PROJEKTET KAPITALE TË KOSTT-it I NËNSHTROHEN AUDITIMIT PUBLIK** F. 8

**SHTYHEN TAKIMET ME PRANI FIZIKE NË FORUMIN E DAVOSIT** F. 8

### SPORT

**MURIOI, NË MES TË FENERBAHÇES DHE GALATASARAYT** F. 11

**Numri i grave në institucionet e sigurisë, i ulët** FAQE 4-5



**PROTESTA E THIRRUR NGA BERISHA: 'BALLKANI I HAPUR', PËRPJËKJE PËR TA IZOLUAR KOSOVËN** FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Protesta e thirrur nga Berisha: 'Ballkani i hapur', përpjekje për ta izoluar Kosovën

TIRANË, 20 DHJETOR - Mijëra shqiptarë janë bashkuar të hënën në protestën kundër "Open Balkan"-it në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë.

Në protestën e thirrur nga ish-kryeministri Sali Berisha morën zyrat e lartë të Partisë Demokratike të krahut të Berishës dhe ish-deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Mlihate Tërmkolli.

Sali Berisha, i cili i priu kësaj proteste, ka drejtuar akuza për kryeministrin Edi Rama sa i përket kësaj iniciative, duke e vlerësuar të dëmshme për Kosovën.

Ish-presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani, në fjalën e mbajtur në protestën kundër vizitës së Vuçiqit në Tiranë, ka thënë se kjo protestë është një moment historik. Ai ka thënë se 'Ballkani i hapur' është projekt antieuropian. "Ballkani i hapur është projekt antieuropian dhe antiperëndimor. Ky projekt po na fërkon përditë e më shumë

me vendet perëndimore. Aleatët e tradhtisë dhe të hajnisë nuk mund të marrin peng PD-në. Ata nuk mund të marrin peng një komb të tërë që ka qenë, është dhe do të mbetet në këmbë", ka thënë Nishani.

Ish-ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Aldo Bumçi, ka thënë se 'Ballkani i hapur' është përpjekje për ta izoluar Kosovën.

Kurse ish-deputetja Tërmkolli ka thënë se 'Ballkani i hapur' është thikë pas shpine për Kosovën. "Në këtë protestë madhështore, në kundërshtim të një pakti djallëzor për 'Ballkanin e hapur', për një thikë pas shpinës për Kosovën. Ne do ta kundërshtojmë përgjithmonë dhe fuqia e popullit është e madhe. Ne do ta kundërshtojmë projektin serb, atë që vetë serbët e quajnë 'Bota serbe'. Por kjo nuk do të ndodhë. Është kalaja Kosovës dhe janë shqiptarët në Shqipëri dhe kudo ku janë", ka thënë Tërmkolli.

Të hënën kryeministri serb



Aleksandër Vuçiq ka qëndruar në Tiranë për t'i vazhduar takimet e iniciativës 'Ballkani i hapur'.

Iniciativa 'Ballkani i Hapur' u krijua më 2019 nga Rama, Vuçiqi dhe Zaevi. Deri në korrikun e vitit 2021 kjo iniciativë është njohur me emërtimin 'Mini-Shengen'. 'Ballkani i Hapur' parasheh

lirinë e lëvizjes së mallrave, kapitalit dhe shërbimeve mes njerëzve të këtyre tri shteteve. Iniciatorët e 'Ballkanit të hapur' deri më tani nuk ia kanë dalë që t'i bindin edhe tri shtetet e rajonit: Kosovën, Malin e Zi dhe Bosnjë e Hercegovinën që të bëhen pjesë e kësaj iniciative.

Më 15 dhjetor presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka theksuar se iniciativa rajonale 'Ballkani i hapur' nuk u ndërtua mbi parimet e bashkëpunimit rajonal dhe shtoi se të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë trajtim të barabartë në këtë iniciativë.

## Osmani: Nëse ka vullnet politik, në janar zgjidhet kontesti me Sofjen

SHKUP, 20 DHJETOR - Maqedonia e Veriut pret që në janar të vitit 2022 të ketë marrëveshje me Bullgarinë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe heqjen e vetos për nisjen e bisedimeve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian në rast se do të ketë vullnet politik nga qeveria e re bullgare, ka deklaruar ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani.

Kryediplomati i Maqedonisë së Veriut, Osmani, i bëri këto deklarata teksa komentoi pritjet e zyratëve bullgare për bisedime në gjashtë muajt e ardhshëm për çështjet që lidhen me ekonominë, infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë e sfera të



tjera, përkaj atyre për historinë. Osmani tha se në rast se ka vullnet politik, marrëveshja

mund të arrihet qysh në janar, për të ruajtur jo vetëm besueshmërinë e BE-së, por

edhe dinamikën e zhvillimit rajonal. "Duke pasur parasysh rrjedhën e bisedimeve, afat prej gjashtë muajve është shumë i gjatë për të kapërcyer dallimet dhe shumë i gjatë për fillimin e negociatave mes BE-së dhe Maqedonisë Veriut, sepse besueshmëria e bllokut evropian nuk mund të zgjasë edhe gjashtë muaj, por dinamika rajonale vështirë se mund të mbahet me gjashtë muaj shtesë të paparashikueshëm. Nëse ka vullnet politik, janari mund të jetë mundësia e radhës për t'i kapërcyer dallimet", ka thënë Osmani pas takimit me ministrinë e Jashtëm të Hungarisë, Peter Szijjarto.

Szijjarto tha nga Shkupi se "Hungaria e vlerëson si të pandershëm qëndrimin e Bashkimit Evropian për të mos caktuar datën për nisjen e bisedimeve të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë". "Vendimi është konfuz dhe frustrues andaj edhe i bëjmë thirrje BE-së që menjëherë t'i nisë bisedimet e anëtarësimit me dy vendet", tha Szijjarto. Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha se Shkupi nuk pret që korniza negociuese të miratohet pa datën për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare me Bashkimin Evropian.

## Sërish hidhet ngjyrë mbi muralin kushtuar Mlladiqit

BEOGRAD, 20 DHJETOR - Një grup i personave të panjohur kanë hedhur ngjyrë mbi muralin kushtuar kriminelit të luftës, Ratko Mlladiq, që është vendosur në Beograd.

Murali, që ka pesë muaj që është vendosur në fasadën e një ndërtese në qendër të Beogradit, mëngjesin e 20 dhjetorit u pa se ishte lyer

me ngjyrë të zezë. Po ashtu, ishin hequr edhe flamujt të Serbisë që kishin qenë të vendosur pranë muralit.

Ngjyrë është hedhur edhe mbi muralin kushtuar komandantit çetnik në Luftën e Dytë Botërore, Drazha Milhailloviq, që gjendet pranë muralit të Mlladiqit.

Personat që kanë hedhur ngjyrë ndaj muraleve nuk

kanë lënë ndonjë mesazh. Që prej se autorë të panjohur pikturuan portretin e Mlladiqit në korrik të këtij viti, i njëjti është ngjyrosur disa herë, por sërish brenda orësh është kthyer në gjendjen origjinale, pasi që murali është punuar me një llak të veçantë që mundëson që të pastrohet lehtë.





# Kërkohet heqja e orës policore

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, kanë kërkuar nga qeveria heqjen e orës policore për festat e fundvitit. Drejtori ekzekutiv i AKK-së, Sazan Ibrahim, dhe i pari i AAK-së, kanë thënë se nuk ka asnjë argument shkencor i cili tregon se kjo masë ndihmon në luftimin e përhapjes së pandemisë Covid-19. Sipas tyre, ndalimi i qarkullimit do të jetë një pengesë për diasporën që do të vijë për festat e fundvitit në Kosovë

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Në kohën kur shumë vende të Evropës kanë shtrënguar masat kundër Covidit shkaku i variantit të ri "Omicron", në Kosovë po kërkohet lirimi i këtyre masave. Përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, kanë thënë se nuk ka asnjë argument shkencor se kjo masë ndihmon në luftimin e përhapjes së pandemisë.

Drejtori ekzekutiv i AKK-së, Sazan Ibrahim, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ora policore do të jetë vetëm pengesë për qytetarët gjatë festave të fundvitit. "Asociacioni i Komunave të Kosovës së bashku me drejtorët komunalë i kanë përkrahur dhe do t'i përkrahin të gjitha masat që kanë dhënë rezultat dhe japin rezultat sa i përket parandalimit të përhapjes së Covid-19, por kemi edhe argumente shkencore që ora policore nuk e lufton pandeminë", ka thënë Ibrahim.

Ai ka vlerësuar se lehtësira duhet të ketë edhe për qytetarët e imunizuar. "Gjithashtu, gjatë festave të fundvitit masa e orës policore duhet të largohet në tërësi. Kërkojmë edhe nga diaspora që të vaksinohet, në mënyrë që edhe ne të kemi një fundvit të suksesshëm dhe ta festojmë në mënyrë të dinjitetshme. Besojmë që vetëdija e qytetarit në Kosovë dhe jashtë saj është në nivel të tillë që të

vaksinohen apo të imunizohen, sepse po shihet që vetëm vaksinimi apo imunizimi është arma e vetme që po lufton parandalimin e përhapjes së Covid-19", ka thënë ai.

Të njëjtën kërkesë për qeverinë e ka pasur edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka bërë me dije se ndalim-qarkullimi është masa kundër diasporës në vend. "Të dashur motra e vëllezër që jetoni jashtë vendit, rugët tuaja drejt vendlindjes nuk u ndalën asnjëherë, as dikur në rrethana okupimi e as sot në liri. Ju u jepni kuptim festave të fundvitit, të cilat do të ishin të zbehta pa ju dhe kjo jo vetëm për faktin që familjet çmallen me ju, por edhe gjallërimi që i bëni ekonomisë së shtetit tonë të përbashkët, vendlindjes suaj. U bë më shumë se një vit që edhe Kosova po përballet me pandeminë ashtu sikur vendet ku jetoni e punoni ju. Fatmirësisht, në këtë fazë ne kemi shumë më pak të infektuar", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, Kosova duhet ta mirëpresë diasporën e jo ta kufizojë lëvizjen e tyre. "Sot i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës, që të heqë masën e ndalim-qarkullimit, për të mundësuar kështu udhëtim të lirë e pa pengesa për diasporën tonë. Ne duhet t'i mirëpresim motrat e vëllezërit tanë e jo t'i kufizojmë me masa që ekspertët po i konsiderojnë joshkencore dhe jo të nevojshme për menaxhimin e pandemisë!", ka shkruar Haradinaj.



## Ministria e Shëndetësisë kundër lirit të masave

Një ditë më parë institucionet shëndetësore janë shprehur kundër lehtësimit të masave kundër Covidit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik u kanë bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që t'i respektojnë masat kundër Covidit edhe gjatë festave të fundvitit. "Dhjetori na gjen me situatën epidemiologjike relativisht të qetë, mirëpo nën rrezikun e lartë për një valë të re gjatë javëve në vijim, gjë që na detyron përsëri ta rritim vigjilencën tonë. Si gjithnjë, do t'i mirëpresim mërgimtarët tanë sepse janë pjesë integrale e shoqërisë sonë, megjithëse edhe kësaj radhe do të na duhet të kufizohemi nga manifestimet

masive, sepse paraqesin rrezik të lartë në këtë situatë", ka bërë me dije Ministria e Shëndetësisë.

Kjo ministri ka treguar se masat do të lehtësohen vetëm pas analizave të reja epidemiologjike dhe rekomandimeve të institucioneve shëndetësore. "Ministria e Shëndetësisë nuk njeh detyrë më të rëndësishme sesa të mbrojë jetën dhe shëndetin e qytetarëve tanë, me të gjitha mjetet që i ka në dispozicion. Për këtë arsye janë ndërmarrë masat kufizuese edhe brenda vendit, edhe në pikat kufitare, duke marrë parasysh rreziqet e lartpërmendura. Megjithatë, jemi vazhdimisht duke shqyrtuar të dhënat më të reja të analizës epidemiologjike dhe rekomandimet e

institucioneve shëndetësore mbi të cilat ne do t'i përditësojmë masat konform situatës dhe shkallës së rrezikshmërisë", ka treguar MSh-ja.

Edhe IKShPK-ja ka bërë me dije se situata epidemiologjike mund të përkeqësohet në rast të rritjes së rasteve të reja. "Ne jemi duke vazhduar pa ndërprerë gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik. Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet në rast të rritjes së rasteve të reja, andaj IKShPK apelon te të gjithë qytetarët që të festojmë së bashku duke respektuar masat sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës", ka bërë me dije IKShPK-ja.

## Gjykata Speciale mbyll punimet deri më 7 janar

HAGË, 20 DHJETOR (ER) - Të hënë e 20 dhjetorit Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë zyrtarisht kanë filluar pushimin dimëror, i cili, sipas kalendarit zyrtar, do të zgjasë deri më 7 janar të vitit 2022.

Për 19 ditë në Gjykatën Speciale nuk do të zhvillohen seanca gjyqësore për ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ndërsa seanca e parë e paraparë që të mbahet më 11 janar të vitit të ardhshëm pas përfundimit të pushimit dimëror do të jetë ndaj ish-kryerëve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Ndërsa gjykimi tjetër në Gjykatën Speciale për ish-komandantin e UÇK-së, Salih Mustafa, pritet të vazhdojë më 18 janar të vitit të ardhshëm.

Hysni Gucati së bashku me Nasim



Haradinaj po akuzohen për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe

për shkelje të fshehtësisë së procedurës. "Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z.

Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tre konferenca

shtypi edhe aktivitete të tjera të transmetuara, si dhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale", thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Në anën tjetër, aktakuza ndaj Salih Mustafës është konfirmuar më 12 qershor 2020, ndërsa ai u arrestua më 24 shtator të vitit të kaluar, me pretendimin për krime lufte. "Aktakuza e konfirmuar përcakton se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në një kompleks ndalimi në Zllash, Kosovë, u kryen krimet e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe të torturës kundër të paktën gjashtë personave. Gjithashtu, në aktakuzë thuhet se në një datë midis 19 prillit 1999, ose rreth kësaj date, dhe rreth fundit të prillit 1999, në atë vendndodhje u vra një i ndaluar", ka njoftuar Gjykata Speciale përmes një komunikate.





MBAHET KONFERENCA "AGJENDA PËR BARAZI GJINORE NË POLICINË E KOSOVËS  
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2021-2023"

# Numri i grave në institucionet e sigurisë, i ulët

Numri i grave në institucionet e sigurisë vazhdon të jetë i ulët, u tha të hënën në konferencën për lansimin e agjendës për barazi gjinore në Policinë e Kosovës dhe planit të veprimit 2021-2023. Po ashtu, u tha se vetëm 15 për qind e të punësuarve në polici janë gra. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka theksuar se gratë dhe vajzat në Policinë e Kosovës me profesionalizimin e tyre kanë dëshmuar se janë të gatshme që t'i kryejnë detyrat e përcaktuara duke udhëhequr në të gjitha nivelet organizative në polici

kryejnë detyrat e përcaktuara duke udhëhequr në të gjitha nivelet organizative në polici. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka theksuar se mbi 15 për qind e të punësuarve në Policinë e Kosovës janë gra. "Policia vazhdon të jetë shembull për barazi gjinore jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Funksionimi i shoqatës brenda policisë është një vlerë tjetër në Kosovë. Pjesëmarrja e vajzave dhe grave në polici është mbi 15 për qind", ka thënë ai. Presidentja Vjosa Osmani, e cila ishte pjesë e kësaj konference, ka thënë se nder elementet kryesore të sundimit të ligjit është barazia e të gjithëve para ligjit. "Në këtë kontekst, në veçanti duhet përmendur gratë dhe burrat të cilët kanë punuar jashtëzakonisht shumë për të na sjellë në këtë fazë në të cilën jemi sot, dhe janë të vetëdijshëm se mbështetja jonë institucionale ndaj tyre do t'i përcaktojë kushtet për sot, por

edhe për të ardhmen e vajzave tona nga të gjitha sferat e jetës e nga të gjitha komunitetet të cilat do t'i shërbejnë vendit me nder e krenari, të barabarta në sfida dhe të barabarta në avancim", ka thënë Osmani, duke shtuar se pabarazitë gjinore ndikojnë edhe në shkallën e krimit dhe në viktimat e tij. "Këto pabarazi, gjithashtu, ndikojnë në mënyrën se si luftohet krimi. Sa më shumë barazi në institucionet e sigurisë, po aq më shumë do të mbrohen viktimat dhe po aq shumë do të sillen para drejtësisë autorët e krimeve. Kjo është arsyeja pse barazia gjinore në polici dhe institucione të tjera të sigurisë është kaq e rëndësishme, por edhe e domosdoshme. Barazia gjinore i ka sfidat e veta të cilat janë rritur në Sektorin e Sigurisë për një sërë arsyesh. Rekrutimi policor, trajnimi, zhvillimi profesional, specializimet, avancimi në karrierë, vendimmarrja,

udhëheqja dhe menaxhimi ekzekutiv - mundësitë e barabarta bazuar në merita dhe profesionalizëm, janë sfida të vazhdueshme në gjithë sektorin e sigurisë", ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se institucioneve u mbetet detyrë e përhershme që barazinë gjinore ta bëjnë pjesë të angazhimit të tyre të përditshëm, në funksion të efikasitetit, të cilësisë dhe profesionalizimit të shërbimeve, të cilat pastaj e rritin edhe mirëqenien qytetare. "Gratë në uniformë ishin pjesë e gjeneratave të para të Policisë së Kosovës. Ky synim ka nisur atëkohë e duhet të vazhdojë edhe më fuqishëm tash e tutje. E para tyre, kishte shumë gra që kontribuan në rezistencën tonë dhe që gjatë luftës mbrojtën atdheun e tyre e të cilat dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në lirinë tonë, kontribut ky që shpeshherë injorohet. Ato gra që dhanë gjithçka që ne sot të

**EPOKA  
ERE****Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 20 DHJETOR** - Të hënën në Prishtinë është mbajtur konferenca "Agjenda për barazi gjinore në Policinë e Kosovës dhe planit të veprimit 2021-2023", ku morën pjesë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, manaxhmenti i PK-së dhe partnerë të tjerë. Në këtë konferencë u potencuan nevoja dhe rëndësia

e rritjes së përfaqësimit dhe përfshirjes së grave në sektorin e sigurisë dhe në përgjithësi avancimin e tyre në funksion të garantimit të të drejtave njerëzore në përgjithësi dhe ofrimit të shërbimeve sa më efikase dhe cilësore për qytetarët pa dallim. Si nikoqir në këtë konferencë drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, në fjalimin e tij theksoi se gratë dhe vajzat në Policinë e Kosovës me profesionalizimin e tyre kanë dëshmuar se janë të gatshme t'i



# Arrihet marrëveshja, Kosova i jep Danimarkës në shfrytëzim 300 qeli burgu

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Në objektin e Qeverisë së Kosovës është nënshkruar të hënën një dokument, sipas të cilit, 300 qeli burgu të Kosovës do t'i jepen në shfrytëzim shtetit të Danimarkës.

Të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të këtij dokumenti kanë qenë përfaqësues nga Mbretëria e Danimarkës, ministrja e Drejtësisë Albulena Haxhiu si dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli. Ministria Haxhiu ka thënë se Kosova është vlerësuar në aspektin e sundimit të ligjit dhe, sipas saj, për këtë arsye është përzgjedhur. "Në Qendrën Korrektuese do të vendosen 300 të burgosur në një afat 5+5", ka thënë Haxhiu, e cila ka njoftuar se detajet më të hollësishme do të jepen më vonë.

Ministri i Drejtësisë i Danimarkës, Nick Hakkerup, ka thënë se nga marrëveshja do të përfitojnë të dyja palët. Ai ka

përmendur mundësinë e hapësirave në burgjet e Danimarkës, duke falënderuar Kosovën për mundësinë e zhvendosjes së të burgosurve. "Sapo nënshkruam një letër-qëllim. Këtë e shohim si një gurtëmel për marrëveshjet e ardhshme. Nga kjo marrëveshje do të përfitojnë të dyja palët. Shërbimi Korrektues i Danimarkës është i mbingarkuar dhe për këtë arsye para një viti e kemi kontaktuar Qeverinë e Kosovës. Kemi kërkuar ndihmë nga disa vende për ta zgjidhur këtë problem, por Kosova ka qenë vendi i parë që ka reaguar pozitivisht ndaj kërkesës sonë dhe është angazhuar pozitivisht më pas në dialog për këtë çështje", ka thënë Hakkerup.

Ai ka pohuar se qendrat e paraburgimit do të menaxhohen sipas ligjeve të Danimarkës. "Menaxhimi do të jetë nën lidhshpinë e autoriteteve të Danimarkës, por do të ketë



trajnim edhe për stafin vendas. Danimarka do t'i respektojë të gjitha ligjet sa i përket sistemit dhe trajtimit të burgosurve", ka deklaruar Hakkerup.

Ministria e Drejtësisë para disa ditësh ka njoftuar se të dënuarit të cilët do të transferohen në këtë institucion nuk do të jenë të

rrezikshmërisë së lartë.

Si kompensim për këtë, Republika e Kosovës përfiton 210 milionë euro, të cilat do të dedikohen edhe në investime kapitale, në veçanti për energjinë e ripërtërishme.

Nga ky kompensim do të përfitojnë në masë të madhe

edhe institucionet e drejtësisë, po ashtu edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndaj të cilit do të ndikojë në ngritjen e cilësisë dhe infrastrukturës së përgjithshme të këtij shërbimi. Marrëveshja parashihet të gjejë zbatim të plotë në periudhën dhjetëvjeçare.

## Pacolli thotë se ia ka sjellë edhe një njohje Kosovës, Kurti ende s'i ka kthyer përgjigje



PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), deputeti Behgjet Pacolli, ka bërë me dije se një shtet të cilit nuk ia ka përmendur emrin, e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Përmes një letre i është drejtuar kryeministrit Albin Kurti, duke thënë se presidenti i shtetit në fjalë ka shprehur gatishmërinë për ta vizituar Kosovën në mënyrë që të formalizohet njohja. Ai ka hedhur akuza ndaj Kurtit për neglizhim, pasi thotë se i ka dërguar në 'Whatsapp' letrën e presidentit dhe konfirmimin e tij ndaj Kosovës.

Më tutje, ai ka përmendur

vetën e tij për zgjedhjen e presidentit dhe mospërgjigjen e Kurtit ndaj mesazheve edhe, siç thotë Pacolli, lirim të instrumenteve mjekësore për spitalin e pediatrikë që ishin bllokuar në терминалет doganore. "Takimi ynë i fundit me ju ishte një natë para zgjedhjeve presidenciale, kur ju kishit nevojë për votën time. Duke e ditur se ju nuk përgjigjeni në letrat e mia, (ashtu siç nuk u përgjigjet as atyre letrave që kërkoja lirim të instrumenteve mjekësore, sipas rregullave, për spitalin e pediatrikë që i kishit bllokuar në терминалет doganore. Duke

ditur këtë, më mbetet vetëm t'ju drejtohem publikisht: Në 'WhatsApp', më datën 18/12, ju kam dërguar letrën dhe mesazhin e presidentit të shtetit që konfirmon se janë të gatshëm (javën e ardhshme) ta vizitojnë Kosovën për t'i kryer formalitetet e njohjes dhe të diskutojnë për vizitën e juaj në këtë shtet. Gjithçka është e rregulluar, zotëri kryeministër. Unë kam punuar gjatë për këtë njohje dhe pritjet vetëm miratimi juaj. Unë, si gjithmonë, jam në dispozicion për gjithçka që keni nevojë rreth kësaj njohjeje", ka shkruar Pacolli.

kemi institucione të lira e të pavarura e të barabarta për të gjithë qytetarët janë burim i vazhdueshëm inspirimi për rrugën që kemi përpara", ka thënë Osmani.

Edhe kryeministri Albin Kurti ka thënë se arritja e barazisë gjinore brenda dhe përmes policisë nuk ka të bëjë thjesht me rritjen e numrit të grave në forcat policore, por ka të bëjë edhe me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. "Ndërsa rritja e pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë, përveçse synim, ka edhe për rezultat rritjen e cilësisë, shpejtësisë dhe sigurisë së shërbimit për qytetarët, sikurse edhe besimin ndaj institucionit të policisë.

Çdo rast i raportimit të dhunës në baza gjinore është besim i shprehur në Policinë e Kosovës, andaj kur gratë raportojnë dhunën, ato duhet të gjejnë jo vetëm një polici që e merr deklaratën e tyre, por një që e mbështet, i mbron dhe i përkrah ato", ka thënë kryeministri.

Ai ka shtuar se për të angazhuar më tepër vajza dhe gra në këtë sektor duhet përkujdesje e të gjithëve. "Në të njëjtën kohë, përfshirja sa më e madhe e grave në polici duhet të përcillet edhe me pjesëmarrje të tyre në vendimmarrje. Pra, nuk mjafton thjesht përfshirje formale, por duhet pjesëmarrje aktive", ka deklaruar kryeministri Kurti.





## Kryetari i Gjilanit premtion funksionalizimin e kamerave të sigurisë

**GJILAN, 20 DHJETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur të hënën në takim një delegacion të policisë në krye me drejtorin e Drejtorisë Rajonale, kolonel Agron Rukiqi. Hyseni pasi e ka falënderuar për vizitën kolonelin Rukiqi,

ka konfirmuar bashkëpunimin e komunës me policinë në funksion të sigurisë së qytetarëve. Në këtë takim kryetari Hyseni është shprehur, po ashtu, se do të angazhohet që objekti i Drejtorisë Rajonale të përfundohet sa më parë, sikurse edhe që do të bëhet

funksionalizimi i kamerave të sigurisë. Kurse drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjilan, kolonel Agron Rukiqi, e ka falënderuar kryetarin Hyseni për pritjen, derisa u pajtuar që edhe në të ardhmen takimet të jenë të vazhdueshme në funksion të sigurisë publike.



## Rriten prej 220-përqindësh të hyrat nga pagesat ujore

**PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER)** - Këshilli Ndërmënytor i Ujërave ka mbajtur takimin e parë në përbërjen e tij të re në të cilin ishte i pranishëm edhe kryeministri Albin Kurti. Në kuadër të diskutimit mbi gjendjen e sektorit të ujërave në Kosovë dhe orientimit strategjik të Qeverisë së Kosovës në këtë fushë, kryeministri Kurti ka thënë se janë të përkushtuar për zhvillimin e sektorit të ujërave dhe se beson që kjo qeveri është më aktivja deri më tani në përparimin e këtij sektori.

Duke renditur disa prej veprimeve që qeveria ka ndërmarrë deri më tani, Kurti ka thënë se kanë krijuar grupin punues për kthimin e ligjshmërisë në dhënie e së drejtës ujore me qëllime komerciale. Gjithashtu, sipas tij, kanë ndaluar



dhënie e pasurisë ujore pa koncesion. “Kemi miratuar programin për Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore,

kemi miratuar financimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për Gjilan dhe Mitrovicë. Kurse sa i përket


qeverisjes së korporatave në ndërmarrjet rajonale të ujërave dhe ujitjes, kemi emëruar bordet e përkohshme të drejtorëve me

përbërje të barabartë grash dhe burrash dhe jemi në proces të përzgjedhjes së bordeve të drejtorëve për shumë ndërmarrje të tjera”, ka thënë Kurti.

Ai ka veçuar rritjen prej 220-përqindësh në të hyrat nga pagesat ujore si dëshmi e angazhimit të qeverisë dhe ndërmarrjeve publike në grumbullimin e të hyrave, por edhe e besimit të lartë të qytetarëve ndaj qeverisë dhe institucioneve vartëse.

Të vetëdijshëm për rezervat e ulëta ujore në vend të cilat nuk kalojnë shifrën prej 500 milionë metrash kube ujë, kryeministri Kurti ka ritheksuar synimin e qeverisë për të rritur këto kapacitete duke ndërtuar dy diga të reja brenda këtij mandati, gjatë të cilit synohet edhe përfundimi i ndërtimit të impianteve në shtatë qendrat e mëdha të Kosovës.

## Pas miratimit të buxhetit, Kamenica merr përkrahje për tri projekte



**KAMENICË, 20 DHJETOR (ER)** - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, ka thënë se pas miratimit të buxhetit për vitin 2022 në Kuvendin e Kosovës, Kamenica ka marrë përkrahje për disa projekte. Sipas tij, këto projekte do të fillojnë brenda vitit 2022. “Me shumicë votash u miratua buxheti për vitin 2022, i cili është më i madhi ndonjëherë në historinë e Kosovës. E falënderojmë deputeten Arta Bajralija e cila i ka dërguar amendamentet të cilat i kemi shqyrtuar së bashku. Më pas,

këto projekte u përkrahën nga Komisioni për Buxhet dhe Transfere, e të cilat do të fillojnë brenda vitit 2022. Projektet për Kamenicën janë: Ndërtimi i kolektorëve për ujëra të zeza në Hogosht dhe Shipashnicë; ndërtimi i çerdhës në fshatin Koretin; asfaltimi i rrugës ‘Varrezat e dëshmoreve - Jallaqë’. E falënderojmë Qeverinë e Kosovës, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ky është vetëm fillimi. Ditë të mira na presin”, ka thënë kryetari Rahimaj.

## Kryetari i Malishevës shpërndau dhurata për nxënësit me nevoja të veçanta

**MALISHEVË, 20 DHJETOR (ER)** - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka vizituar të hënën shkollën “Ibrahim Mazreku” në këtë komunë, përkatësisht klasën me nxënës me nevoja të veçanta, të cilëve edhe u ka shpërndarë dhurata në prag

të festës së Vitit të Ri 2022. “Në prag të festave të fund vitit, me kënaqësinë më të madhe sot kam vizituar nxënësit me nevoja të veçanta, që vijnë në mësimet në ShFMU ‘Ibrahim Mazreku’ në Malishevë. Në cilësinë e kryetarit të Malishevës, këtyre

fëmijëve të dashur u shpërndava nga një dhuratë për festën e Vitit të Ri dhe u urova shëndet të mirë dhe suksese në vitin 2022”, ka thënë Kastrati, duke shtuar se fëmijët do të kenë përkrahje dhe trajtim të barabartë institucional.





## Ministri Mehaj: Synimi ynë, avancimi i aftësive të mbrojtjes kibernetike të FSK-së

Prishtinë, 20 dhjetor (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se siguria kibernetike është një nga sfidat e rëndësishme në botën bashkëkohore për shkak të kompleksitetit të saj. Ai ka thënë se një ndër synimet e tij si ministër është zhvillimi dhe avancimi i aftësive dhe kapaciteteve të sigurisë dhe

mbrojtjes kibernetike të FSK-së si aset edhe i sigurisë sonë kombëtare. "Falënderim dhe mirënjohje shumë e lartë për ekspertët e Gardës Kombëtare të Iowas për mbështetjen e FSK-së për ngritjen e kapaciteteve për siguri kibernetike. Fokusi i punëtorisë së fundit ka qenë trajnimi i personelit tonë në

fushën TI-së dhe sigurisë kibernetike, si dhe vizitat për krijimin e kontakteve me universitetet dhe kolegjet në Kosovë për planifikimin e Garës në Mbrojtjen Kibernetike në mes të universiteteve të Iowas dhe atyre nga Kosova e cila planifikohet të realizohet gjatë vitit 2022", ka deklaruar Mehaj.



## "Ballkani i hapur" me shumë pikëpyetje të reja

Milazim KRASNIQI

Pjesëmarrja në takimin e së hënës të "Ballkanit të hapur" në Tiranë e O. Brajanit, si përfaqësues i Këshillit Atlantik dhe i komisionarit për zgjerim të BE-së, Oliver Varhejlit, paraqet një moment të ri këtej iniciative. Gjasat janë që NATO dhe BE duan ta mbajnë nën kontroll këtë iniciativë, që të mos dalë plotësisht nga binarët e procesit të zgjerimit të NATO-s dhe të anëtarësimit të shteteve ballkanike në BE. Pra, një mundësi është që tash e tutje "Open Ballkan" mund të jetë nën kontrollin e NATO-s dhe të BE-së, për ta dobësuar influencën ruse, e cila është kumbara i "Open Ballkan". Megjithatë, e paqartë mbetet pozita e Aleks Sorosit në atë takim e në tërë këtë iniciativë. Nuk është e qartë a e përfaqëson ShBA-në një agjent joqeveritar si Fondacioni "Soros?" në këtë iniciativë? Nëse e përfaqëson, kjo paraqet një sfidë për

Departamentin Amerikan të Shtetit, për të cilin kurrë nuk mund të thuhet se nuk ka kapacitete e autoritet për përfaqësimin zyrtar e legal të interesave amerikane në botë. A mos po përdoret Soros si karrem, për ta afruar disi Vuçiqin me ShBA-në e për ta larguar nga Putini? A mos po përdoret Borellin? A mos po punohet për formimin e një "Bashkimi Ballkanik", si kundërpeshë e Bashkimit Evropian dhe ku rindahen sferat e interesave amerikane e ruse, të cilat në Bashkimin Evropian praktikisht janë zbehur ose edhe eliminuar?

Pra, mund të jetë se është në pyetje një lojë e madhe, e cila po fillon me tre lojtarë të vegjël, Vuçiqin, Ramën e Zaevin, i cili tashmë politikisht është jashtë loje, por vazhdon të jetë aktiv, duke mbledhur topat jashtë fushës.

Një gjë është e sigurt: Vuçiqi vetë përsërit shpesh se asnjë vendim nuk e merr pa u konsultuar me Putinin. Logjikisht edhe



propozimi i iniciativës "Ballkani i Hapur", edhe zhvillimet e derisotme të kësaj iniciative, Vuçiqi i ka në pajtim me Putinin. A po hyn në lojë NATO e BE për

ta marrë nën kontroll këtë iniciativë? Kjo vërtet është pyetje për një milion dollarë. Përtej kësaj pyetjeje të vështirë, vetëm një përgjigje është e ditur saktë:

çdo iniciativë serbe e ruse është gjithmonë në dëm të shqiptarëve. Kjo nuk ndryshon as në rastin e kësaj iniciative. (20 dhjetor 2021)

## Financohet projekti për trajtimin e personave me nevoja të veçanta

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Si asnjëherë më parë, me votimin e buxhetit nga Kuvendi i Kosovës për Shërbimin Korrektues të Kosovës, do të financohet Projekti për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta. Vlera totale e projektit është 412 924 euro. Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta do të jetë i vendosur në Qendrën Korrektuese të Dubravës dhe do t'i mbulojë shërbimet shëndetësore



të personave të privuar nga liria, veçanërisht grupeve të ndjeshme me nevoja të veçanta, personat që

kanë rrezik vetëvrasje dhe çrregullime akute, të përkohshme, mendore, trajtimi i varësive,

trajtimi zëvendësues terapia okupuese dhe rehabilitimi, ku pa rrezikuar sigurinë do të ofrohet kujdes shëndetësor adekuat profesional. Institucioni do të mundësojë trajtim human, dinjitoz, profesional dhe adekuat për këto kategori të personave me nevoja të veçanta. Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve dhe partnerët ndërkombëtarë do të punojnë për vendosjen, sistemimin dhe akomodimin për

trajtimin e kësaj kategorie në bazë të nevojave dhe kërkesave të tyre, çdoherë duke u mbështetur në standarde të afirmuara ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira. Për realizimin e këtij projekti, Shërbimi Korrektues i Kosovës falënderon Ambasadën Amerikane, EULEX-in dhe Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, veçanërisht ministrin Albulena Haxhiu për mbështetjen dhe përkrahjen e fuqishme falë së cilës projekti tashmë po realizohet.

## Biopsia e palcës kockore tash e tutje do të kryhet në Kosovë

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Klinika e Pediatriisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka aktivizuar një shërbim të ri

diagnostik. Në Repartin e Hemato-Onkologjisë ka filluar të realizohet biopsia e palcës kockore nga një ekip mjekësh

i trajnuar mirë, një procedurë shumë e rëndësishme, por e kushtueshme, e cila më herët është kryer vetëm jashtë vendit.

QKUK-ja ka njoftuar se rritja dhe përmirësimi i shërbimeve mjekësore për pacientin është obligim dhe prioritet i përbashkët yni.





# A Hotbed of Cloak-and-Dagger Skullduggery in the Hague

Hague-based prosecutors consistently fail to live up to the high-minded ideals that they purportedly serve.

The Dutch city of The Hague has a reputation for judicial integrity and independence. It is the seat of the International Court of Justice, the International Criminal Court, and a number of ad hoc tribunals that include the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, the Special Tribunal for Lebanon, and the Kosovo Specialist Chambers Tribunal, whose remit is to try Kosovars accused of war crimes in that nation's struggle for independence fifteen years ago. Unfortunately, Hague-based prosecutors consistently fail to live up to the high-minded ideals that they purportedly serve. In two high-profile cases involving Lebanon and Kosovo, their overzealous use of tainted evidence and other examples of prosecutorial misconduct call into serious question the integrity of these courts.

After fifteen years of legal proceedings at a cost of almost \$1 billion, the Special Tribunal for Lebanon convicted only one of the four defendants for his involvement in a bombing that

killed Prime Minister Rafiq Hariri and twenty-one others in 2005—and the guilty assassin was never even apprehended. Not content to accept its impotent failure to bring the perpetrators to justice, the court targeted innocent bystanders in a misguided attempt to distract attention from its impotence and to justify its outrageous budget (which was in part paid by the people of Lebanon).

In 2015, the court-initiated proceedings against Karma Khayat, a Lebanese journalist who is accused of jeopardizing court proceedings by publishing a list of prosecution witnesses. A box containing such information had been mysteriously left at her television studio. In her defense, Khayat said her reports had been aimed at exposing leaks emanating from the Special Tribunal for Lebanon. "We had received a list of witness names," she said. "We were not sure of the source so I didn't know if they were correct. Once we were sure they were correct ... we covered the names and covered the faces.

We said something should be done to stop the leaks."

Yet despite these questions surrounding the source of the leaks, the court deemed the matter unworthy of investigation, leaving critics with a host of unanswered questions.

Fast forward five years, and another ad hoc court in the Hague is up to the same old tricks. In September 2020, a person "wearing glasses, a mask and a hat" walked into the Pristina offices of the Kosovo Liberation Army War (KLA) veterans' association and handed over some 4,000 documents on the investigations of the Kosovo Special Chambers Tribunal into war crimes allegedly committed by former KLA officials. It was the third time in two months that privileged information from investigators had mysteriously appeared.

As in Khayat's case, the recipients of the documents shared them with the media, after redacting compromising material. Security officials acting on behalf of the court then raided the offices of

the veterans' organization and led its president, Hysni Gucati, and later its vice-president, Nasim Haradinaj, away in handcuffs. The crime? Prosecutors at the Kosovo Special Chamber have charged Gucati and his deputy with obstruction of justice and witness intimidation. In another striking resemblance to the Lebanese proceedings, questions about how and by whom these documents were leaked are being swept under the rug.

Suspicious boxes appearing in offices are not the only irregularities surrounding the Hague-based Kosovo Specialist Chambers, which was established in 2015 to try crimes allegedly committed during and just after the Kosovo war from 1998 to 2000. The president of the Special Chambers provided an extensive briefing for European ambassadors on the charges against defendants before they were officially brought. The court's indictment of former Kosovo president Hashim Thaci was disclosed before a pre-trial judge had confirmed the charges.

Defense lawyers have accused prosecutors of hindering their trial preparations by withholding evidence.

Such irregularities highlight a fundamental weakness of the special ad hoc courts in the Hague. Legal proceedings at the national level are subject to varying degrees of judicial oversight.

Prosecutorial misconduct is grounds for vacating judgements on appeal. No such recourse exists for the defendants in Kosovo.

Justice should be delivered for crimes committed during Kosovo's struggle for independence. But this cannot happen if convictions are secured by means of the cloak-and-dagger skullduggery that tarnishes the Kosovo Special Chambers. Already viewed with suspicion and hostility by many in Kosovo, the court's actions to date only serve to compromise further its claims of impartiality.

Ambassador Adam Ereli is former State Department spokesman for U.S. Secretaries of State Colin Powell and Condoleezza Rice.





# Ereli: Gjykata Speciale po dështon dhe është komprometuar



Në një shkrim autorial për revistën amerikane "The National Interest", Ambasadori Joseph Adam Ereli, ka shkruar rreth dështimit të Gjykatës Speciale dhe mbase nevojës për rishikim të saj.

Ereli është një ish-zyrtar i lartë amerikan, i cili ka shërbyer në detyra të ndryshme brenda departamentit amerikan, por pozitat e tij më të rëndësishme ishin ish-zëdhënës për Sekretarin e Shtetit Amerikan, Colin Powell dhe ish-zëdhënës po ashtu për për Sekretaren e Shtetit, Condoleezza Rice.

Qyteti holandez i Hagës ka një reputacion për integritetin e lartë në sistemin e drejtësisë dhe pavarësisë gjyqësore. Po në këtë qytet janë të vendosura Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime dhe gjithashtu një numër i madh gjykatash të përkohshme ku përfshihen Tribunali Ndërkombëtar për krimet e luftës në Ish-Jugosllavi, Tribunali Special për Lebanon dhe Tribunali i Dhomave Speciale të Kosovës, detyra e të cilit tribunal është të gjykojë kosovarët e akuzuar për krime lufte në luftën e këtij kombi për pavarësi, shkruan Ereli.

Fatkeqësisht, prokurorët në Hagë vazhdimisht dështojnë të jetojnë

në raport me pritjet dhe idealet e larta në të cilët ata thirren dhe të cilave supozohet se u shërbejnë. Në dy raste të profilit të lartë që përfshijnë Lebanonin dhe Kosovën, sforcimi i përdorimit të provave të dyshimta e të ndotura dhe gjithashtu shembuj të tjerë të sjelljes jo të duhur e vë në pikëpyetje të madhe integritetin e këtyre gjykatave.

Pas 15 vjetësh nëpër procedura ligjore që tashmë ka kapur shifrën e shpenzimeve prej 1 miliard dollarësh, Tribunali Special për Lebanonin ka dënuar vetëm një nga katër të akuzuar, për përfshirjen e tij në bombardimet që lanë të vdekur kryeministrin, Rafiq Hariri dhe 21 persona të tjerë në vitin 2005, por atentatori kryesor nuk është kapur asnjëherë.

Jo veç dështimi për të kapur të fajshmit, gjykata shënjestroi persona komplet te pafajshëm në një përpjekje të gabuar për të shpërqendruar vëmendjen nga dështimi dhe pafuqia e saj dhe për të arsyetuar disi buxhetin jashtëzakonisht të lartë, pjesë e rëndësishme e të cilit paguhet nga qytetarët e Lebanonit.

Në vitin 2015 gjykata inicio procedura kundër Karma Khayat, një gazetare lebaneze që është e akuzuar se ka vënë në rrezik procedurat e gjykatës duke

publikuar listën e dëshmitarëve. Një pako që përmbante brenda këta emra dhe informacione të tjera, ishte lënë në mënyrë misterioze tek studiot e saj televizive. Në mbrojtje të saj, Khayat kishte deklaruar se raportimet e saj kishin të bëjnë me ekspozimin e rrjedhjeve nga Tribunali Special.

"Ne kemi pranuar një listë me emrat e dëshmitarëve", tha ajo.

"Nuk ishim të sigurt me burimin, prandaj nuk e dija nëse janë të saktë. Kur u sigurua se ishin, mbuluam emrat dhe mbuluam fytyrat e tyre. Ne menduam se diçka duhej të bëhej për të stopuar rrjedhjet e informacionit nga gjykata".

Prapë, përkundër këtyre pyetjeve që rrethojnë burimin e rrjedhjes së informacionit, gjykata kishte vendosur që të mos merrej me këtë pjesë fare, duke lënë kritiket me plotë pyetje pa përgjigje.

Pesë vjet më vonë, dhe një tjetër gjykatë e tillë në Hagë po shfaqë të njëjtat taktika të vjetra. Në shtator 2020, një person "me syze dielli, maskë dhe kapelë", u fut në zyrën e Organizatës së Veteranëve të Luftës në Prishtinë dhe dorëzoi mbi 4000 dokumente që kishin të bënin me hetimet e Gjykatës Speciale të Kosovës për krimet e supozuara të luftës nga komandantët e UÇK-së.

Ishte hera e tretë në dy muaj që informacionin i profilit të lartë nga hetuesit në mënyrë misterioze po shfaqej në publik.

Njëjtë si në rastin e gazetares Khyat, pranuesit e këtyre dokumenteve, i ndanë ato me mediat, pasi kishin redaktuar materialet komprometuese.

Zyrtarët e sigurisë pastaj duke operuar në emër të gjykatës vërshuan zyrën e veteranëve dhe vunë në pranga Hyseni Gucatin, kryetarin e veteranëve, dhe Nasim Haradinaj, zëvendësin e tij. Po krimi cili ishte? Prokurorët kanë akuzuar Gucatin dhe Haradinajn me ndërhyrje në drejtësi dhe intimidim të dëshmitarëve. Pra një tjetër rast pothuajse identik me atë të Lebanonit, duke lënë kështu të hapura pyetjet se si dhe nga kush rrjedhën këto dokumente.

Kuti të dyshimta që shfaqen nëpër zyra nuk janë të vetmet parregullsi që rrethojnë këtë gjykatë Speciale në Hagë, e cila u themelua në vitin 2015 për të provuar krime, supozuar se janë kryer gjatë dhe vetëm pak pas luftës nga viti 1998 deri në vitin 2000.

Presidentja e Dhomave Speciale kishte bërë një përmbledhje për ambasadorët evropianë rreth akuzave për të akuzuarit para se ata të akuzoheshin. Aktakuza e

Gjykatës për ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi u zbulua para se gjyqtari paraprak t'i konfirmonte ato. Avokatët e mbrojtjes kanë akuzuar prokurorët se po e pengojnë përgatitjen e tyre për mbrojtje të dëshmitarëve duke mos i lëshuar provat.

Këto parregullsi vënë në pah një dobësi fundamentale të këtyre gjykatave "ad hoc" në Hagë.

Për shembull, procedurat ligjore në nivel kombëtar i nënshtrohen shkallëve të ndryshme të mbikëqyrjes gjyqësore. Kur ka sjellje të pahijshme të prokurorisë, atëherë kjo përbën bazë për zbrazjen e aktgjytimeve në apel. Një rekurs i tillë nuk ekziston për të pandehurit në Kosovë.

Drejtësia duhet ta thotë të vetën për krimet e kryera gjatë përpjekjes së kosovarëve për pavarësi. Por, diçka e tillë s'mund të ndodhë nëse të akuzuarit mbahen aty me melo-drama të spiunazhit që njoftosin Dhomat Speciale të Kosovës, shkruan Ereli, përcjell Albanian Post.

Veçse të shikuara me dyshime dhe armiqësi nga shumë veta në Kosovë, veprimet e Gjykatës deri më sot nuk po bëjnë gjë tjetër, pos që po shërbejnë në komprometimin e objektivitetit të gjykatës.



# Projektet kapitale të KOSTT-it i nënshtrohen auditimit publik



**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 20 DHJETOR** - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës në ndërmarrjen publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) në fushën e prokurimit publik me temën "Auditimi i projekteve kapitale (2015-2021)".

ZKA ka njoftuar se qëllimi kryesor i këtyre projekteve kapitale në KOSTT është që të kontribuojnë për ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë. "Trajtimi i kësaj teme të auditimit është i rëndësishëm pasi që KOSTT-i është shoqëri aksionare 100 për qind në pronësi të Republikës së Kosovës, nuk është audituar nga ZKA-ja që nga viti 2010 si dhe për arsye se projektet kapitale janë

me interes të lartë publik dhe ndikim të gjerë social dhe ekonomik. Aktivitetet e prokurimit në KOSTT, sikurse në çdo autoritet tjetër kontraktues, duhet të zhvillohen në pajtim me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë, parime të sanksionuara me ligjin e prokurimit publik dhe më gjerë, që kanë për qëllim të sigurojnë se prokurimi arrin qëllimin e përcaktuar", ka njoftuar ZKA-ja. Më tej në njoftim theksohet se investimet kapitale në KOSTT bëhen nga fondet publike si dhe nga financimet e organizatave ndërkombëtare. "Projektet e financuara nga fondet publike duhet të kryhen sipas Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë, ndërsa në rastet kur projektet financohen nga organizatat e jashtme, procedurat e prokurimit zhvillohen në përputhje me rregullat dhe politikat e caktuara ndërkombëtare të prokurimit",

është bërë me dije në njoftimin e ZKA-së.

Sipas këtij institucioni, gjatë viteve 2015-2021 KOSTT-i ka realizuar projekte kapitale në vlerë prej 78,758,545 eurosh. "Nga kjo vlerë 62,569,411 euro e përbëjnë dy projektet ndërkombëtare, projekti i financuar nga Banka Gjermane 'Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit Faza IV dhe V nga LOT 1 deri 4' dhe projekti i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) 'Zhvillimi i Transmisionit të Kosovës LOT 1 deri 3'. Kurse vlera prej 16 189 134 eurosh përfshinë grupin e projekteve të financuara nga buxheti i KOSTT të cilat, po ashtu, kanë të bëjnë me blerjet dhe rehabilitimin e rrjeteve të transmisioneve të Kosovës", është thënë në këtë njoftim, duke theksuar se objektivi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse menaxhmenti i ndërmarrjes

publike KOSTT është siguruar se projektet kapitale për vitet 2015-2021 janë prioritetizuar dhe planifikuar në mënyrë të duhur si dhe nëse menaxhimi i proceseve të prokurimit është bërë konform legjislacionit në fuqi dhe janë arritur rezultatet e synuara të prokurimit. "Subjekt i këtij auditimi është KOSTT me njësitë vartëse të ndërlidhura me zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale. Për qëllime të verifikimit dhe marrjes së informatave krahasuese do të përfshijmë edhe Drejtorinë për Çmime dhe Tarifa në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, pasi që kjo zyrë bën koordinimin, aprovimin dhe monitorimin e KOSTT mbi këto nisma investive. Po ashtu, subjekti i auditimit është edhe Zyra e Inspektoratit të Energjisë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë për të siguruar se kjo zyrë ka bërë vlerësimin e disa nga pajisjeve elektroenergetike të cilat bëjnë pjesë te projektet

kapitale fushëveprimi i këtij auditimi", ka njoftuar ZKA.

Siç bëhet me dije në njoftim, fushëveprimi i këtij auditimi përfshin kontratat e prokurimit të nënshkruara për periudhën 2015-2021, ku nga gjithsej 148 projekte kapitale të regjistruara, kanë përzgjedhur për auditim 42 projekte në vlerë prej 50 631 956 eurosh duke përfshirë këtu edhe dy projektet me marrëveshje ndërkombëtare. "Përzgjedhja e projekteve është bërë sipas gjyqimit profesional, rëndësisë materiale dhe natyrës së projekteve. Ky auditim synon ta rrisë

llogaridhënien, transparencën dhe integritetin e aktiviteteve lidhur me investimet kapitale në KOSTT dhe aty ku është e nevojshme të ofrojë rekomandime që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë më efektive dhe efikase dhe t'i arrijnë qëllimet e synuara", ka njoftuar Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Shtyhen takimet me prani fizike në Forumin e Davosit

**DAVOS, 20 DHJETOR** - Takimet e radhës me prani fizike në Forumin Ekonomik Botëror, që zhvillohen në Davos të Zvicrës, janë shtyrë për shkak të rasteve të reja të infektimit me variantin "Omicron" të koronavirusit. "Takimet vjetore ishin planifikuar të zhvilloheshin më 17-21 janar 2022 në Davos. Tani ato janë

planifikuar në fillim të verës. Pjesëmarrësit do të kenë qasje në disa sesione që do t'i bashkojnë liderët botërorë në formatin online, për t'u fokusuar në zgjidhjen e sfidave më të mëdha në botë. Pavarësisht prej protokolleve të repta të sigurisë, përhapja e 'Omicron'-it dhe ndikimi në udhëtime, e kanë bërë të

nevojshme shtyrjen", kanë thënë organizatorët përmes një njoftimi për medie. Forumi i fundit me prani fizike në Davos është mbajtur në janar të vitit të kaluar, pak para shpërthimit të pandemisë në Evropën Perëndimore. Edicioni i këtij viti është mbajtur, po ashtu, në formatin online në muajin janar.





# Rusia dhe Ukraina: Luftë apo bllof?



**Nga George FRIEDMAN**

Kur u shemb Bashkimi Sovjetik, e humbi kontrollin e territoreve kufitare perëndimore, të cilat kishin qenë themeli i sigurisë së tij për qindra vite. Ato territore kufitare krijuan një “thelësi strategjike”, që i detyroi pushtuesit të angazhoheshin në fushata ushtarake të gjata dhe raskapitëse, të cilave Rusia mund t’u bënte ballë.

Rusia ishte sulmuar në shekullin XVII nga suedezët, në shekullin XIX-të nga Franca, dhe 2 herë në shekullin XX-të nga Gjermania. Ajo kishte zhvilluar edhe luftëra kundër Turqisë gjatë shekujve XVIII-XIX. Në vitin 1991, këto rajone kufitare u bënë të pavarura, dhe nga pikëpamja ruse, Perëndimi në përgjithësi, dhe Shtetet e Bashkuara në mënyrë specifike, po synonin të vinin nën kontroll shtetet e sapoformuara.

Dhe kjo përbënte një kërcënim ekzistencial për Rusinë. Në një artikull të mëhershëm, unë kam argumentuar se për të mposhtur një armik, duhet më parë të kuptosh objektivisht se si e sheh veten. Dhe nga ana e saj, Rusia e sheh veten si të pambrojtur, veçanërisht ndaj Perëndimit, ku e kanë historikisht origjinën kërcënimet më të rrezikshme për të.

Bjellorusia dhe Ukraina janë zemra e frikës ruse. Kufiri ukrainas, ndodhet vetëm disa qindra km nga Moska, dhe për këtë arsye përbën një kërcënim i madh kur është në duart e armiqve. Distanca nuk do ta raskapitë një armik që sulmon

prej andej.

Nga pikëpamja e Moskës, mosgatishmëria e Shteteve të Bashkuara për ta njohur këtë frikë të madhe, tregon se Uashingtoni ka plane agresive dhe të rrezikshme. Vlera e vetme e imagjinueshme që kanë për amerikanët Bjellorusia dhe Ukraina, është se ajo e vendosin Rusinë në një pozicion ku ajo duhet të kapitulojë para Shteteve të Bashkuara për të gjitha çështjet jetike, ose të rrezikojë një pushtim të drejtpërdrejtë.

Prandaj Rusia duhet të veprojë. Dhe e ka bërë tashmë këtë gjë në Bjellorusi. Vitin e kaluar, presidenti Aleksandër Llukashenko, fitoi në mënyrë të dyshimtë zgjedhjet presidenciale në vend, të cilat janë kritikuar shumë nga Perëndimi.

Rusët ndërhyjnë me shpejtësi për të shpëtuar Llukashenkon, dhe tanimë kanë de facto kontrollin e plotë të Bjellorusisë, duke siguruar kështu Rrafshin e Evropës Veriore, rrugën kryesore të pushtimit nga Evropa drejt Moskës. Kjo lëvizje e shndërron Ukrainën, një shtet shumë më i madh dhe më i rëndësishëm, në fokusin kryesor të Rusesë.

Rusia duket se ka grumbulluar shumë trupa ushtarake përgjatë kufirit me Ukrainën. Nëse synimi është pushtimi i Ukrainës, nuk mjafton vetëm mposhtja e ushtrisë ukrainase, por ushtria ruse mund të pushtojë fizikisht zona kyçe të këtij vendit. Por nëse raportet janë të vërteta, kjo është një lojë e rrezikshme.

Plani i luftës i Rusesë është padyshim sekret. Por qeveria ukrainase ka bërë publike pikëpamjen e saj se si do të

ndodhte një pushtim rus. Plani përbëhet nga 3 fronte kryesore sulmi që synojnë ta izolojnë dhe pushtojnë Kievin: në veri nga Bjellorusia, në jug nga Gadishulli i Krimesë, dhe në perëndim nga Volgograd.

Por kjo strategji ka 3 probleme. I pari është logjistik. Këto forca me shumë divizione do të angazhoheshin në manovra dhe luftime me një intensitet të lartë. Të tria frontet do të duhet që të furnizohen në vijimësi, dhe ndërsa i afrohen Kievit, ato do të merrnin formën e një rrethi. Meqë duhet të supozohet se luftimet intensifikohen me zvogëlimin e avancimit, njëra nga fazat do të kërkonte sasi të madhe të karburanteve.

Faza e dytë do të kërkonte sasi të mëdha municionesh të të gjitha llojeve. Ekziston mundësia e ndërprerjeve të pakoordinuara të përparimit, duke lënë zbuluar krahët e ushtrisë ruse. Problemi i dytë është se kjo strategji do të krijonte një luftë të ndërlikuar, me shumë fronte, dhe të zhvilluar nga trupa që nuk kanë përvojë. Rusët nuk kanë zhvilluar një betejë me kaq shumë divizione që nga Lufta e Dytë Botërore. Ushtria e tyre është kompetente, por asnjë nga komandantët e tyre nuk e ka komanduar në këtë lloj beteje.

Lojërat dhe manovrat luftarake vlejné në parim, por një forcë e paprovuar nën zjarr, ka nevojë për një strukturë komanduese shumë të sofistikuar. Dhe rusët nuk do ta dinë nëse e kanë një të tillë, derisa ta provojnë këtë në praktikë.

Problemi i tretë janë amerikanët, të cilët nuk do të përipien me gjasë të bllokojnë avancimin me

trupat e tyre. Koha është thelbësore, por imponimi i “fërkimit” ndaj një armiku është i vlefshëm në vetvete. Për shembull SHBA-ja është në gjendje të transportojë forcat polake, për të krijuar atë fërkim. (Gjithnjë duke supozuar se polakët janë të gatshëm ta bëjnë këtë).

Por nëse do të zgjidhte të dërgonte trupat e veta, SHBA-ja do ta detyronte Rusinë të angazhohej në luftime në shkallë të plotë, sipas një plani për të cilin nuk ishte përgatitur. Por kërcënimet më të rëndësishëm nga amerikanët, do të ishte fuqia ajrore dhe raketore. Objektivat e tyre do të ishin nyjet logjistike.

Në luftën e blinduar, siç duket që është edhe plani, shkatërrimi i rezervave të karburantit dhe municioneve është i njëjtë me shkatërrimin e tankeve. Rusëve do t’u duhet që ta parandalojnë këtë duke neutralizuar bazat ajrore dhe raketore të SHBA-së, me shumë mundësi në shkallë globale.

Por që ta ndodhë kjo, Rusia duhet që ta përshkallëzonte luftën në statusin e një lufte botërore, dhe në atë pikë rreziqet për Rusinë do të ishin shumë të mëdha. Shtetet e Bashkuara e njohin kërcënimin rus, ose të paktën duan që Rusia të besojë se e ka njohur atë. Deklaratat e presidentit Bajden mbi këtë çështje, nënkuptojnë një nivel shqetësimi, i cili sugjeron se nëse Rusia sulmon Ukrainën, do të kishte një ndërhyrje të SHBA-së.

Nëse Rusia synon që të pushtojë Ukrainën, do të nevojiten disa ndryshime. Por të realizuar një të tillë, ajo mund të ketë nevojë

vetëm për aneksimin e një pjese të Ukrainës në lindje ose në veri. E interesuar të shmangë një luftë në mesin e Euroazisë, kur kërcënimet është i parëndësishëm, SHBA-ja ka të ngjarë të kundërpërgjigjet vetëm me sanksione.

Rusia mund ta përballojë këtë duke kërcënuar me zgjerimin e pushtimit, por pa e kryer këtë të fundit. Kjo e ndryshon dinamikën politike në Evropë, e paaftë për të ngritur vetë një linjë mbrojtëse, do të zgjedhë të zbusë tonet me Rusinë. Sigurisht, i gjithë kërcënimet mund të jetë thjesht një përpjekje për të testuar Bajdenin.

Gjatë Luftës së Ftohtë, testimi i presidentit të ri të SHBA-së, ishte një rutinë e sovjetikëve. Por bërja e këtij testi sot, mund të shihet si një veprimtari me rrezikshmëri të ulët, dhe me përfitime të mëdha. Në fakt, ka shumë kundër argumente mbi pikëpamjen time, se një pushtim i plotë i Ukrainës është shumë kompleks dhe i rrezikshëm për t’u ndërmarrë.

Rusët nuk kanë luksin të përballojnë një humbje, në përpjekjen e tyre për të siguruar Ukrainën në realitetin aktual gjeopolitik. Ata kanë kohë për të lëvizur. Por kjo vetëm nëse Putin, që është i interesuar të ri-caktojë kufirin, është i përgatitur të rrezikojë për hir të lavdisë personale. Ndoshta kjo mund të jetë e vërtetë, por njerëzit e KGB-së janë të trajnuar të jenë të kujdesshëm. Basti im është se ky është një bllof. Por gjithsesi për këtë çështje, unë nuk do të vija në bast shtëpinë time.

“Geopolitical Futures” – Bota.al







# Rusia dhe Ukraina: Luftë apo bllof?



**Nga George FRIEDMAN**

Kur u shemb Bashkimi Sovjetik, e humbi kontrollin e territoreve kufitare perëndimore, të cilat kishin qenë themeli i sigurisë së tij për qindra vite. Ato territore kufitare krijuan një “thelësi strategjike”, që i detyroi pushtuesit të angazhoheshin në fushata ushtarake të gjata dhe raskapitëse, të cilave Rusia mund t’u bënte ballë.

Rusia ishte sulmuar në shekullin XVII nga suedezët, në shekullin XIX-të nga Franca, dhe 2 herë në shekullin XX-të nga Gjermania. Ajo kishte zhvilluar edhe luftëra kundër Turqisë gjatë shekujve XVIII-XIX. Në vitin 1991, këto rajone kufitare u bënë të pavarura, dhe nga pikëpamja ruse, Perëndimi në përgjithësi, dhe Shtetet e Bashkuara në mënyrë specifike, po synonin të vinin nën kontroll shtetet e sapoformuara.

Dhe kjo përbënte një kërcënim ekzistencial për Rusinë. Në një artikull të mëhershëm, unë kam argumentuar se për të mposhtur një armik, duhet më parë të kuptosh objektivisht se si e sheh veten. Dhe nga ana e saj, Rusia e sheh veten si të pambrojtur, veçanërisht ndaj Perëndimit, ku e kanë historikisht origjinën kërcënimet më të rrezikshme për të.

Bjellorusia dhe Ukraina janë zemra e frikës ruse. Kufiri ukrainas, ndodhet vetëm disa qindra km nga Moska, dhe për këtë arsye përbën një kërcënim i madh kur është në duart e armiqve. Distanca nuk do ta raskapitë një armik që sulmon

prej andej.

Nga pikëpamja e Moskës, mosgatishmëria e Shteteve të Bashkuara për ta njohur këtë frikë të madhe, tregon se Uashingtoni ka plane agresive dhe të rrezikshme. Vlera e vetme e imagjinueshme që kanë për amerikanët Bjellorusia dhe Ukraina, është se ajo e vendosin Rusinë në një pozicion ku ajo duhet të kapitulojë para Shteteve të Bashkuara për të gjitha çështjet jetike, ose të rrezikojë një pushtim të drejtpërdrejtë.

Prandaj Rusia duhet të veprojë. Dhe e ka bërë tashmë këtë gjë në Bjellorusi. Vitin e kaluar, presidenti Aleksandër Llukashenko, fitoi në mënyrë të dyshimtë zgjedhjet presidenciale në vend, të cilat janë kritikuar shumë nga Perëndimi.

Rusët ndërhyjnë me shpejtësi për të shpëtuar Llukashenkon, dhe tanimë kanë de facto kontrollin e plotë të Bjellorusisë, duke siguruar kështu Rrafshin e Evropës Veriore, rrugën kryesore të pushtimit nga Evropa drejt Moskës. Kjo lëvizje e shndërron Ukrainën, një shtet shumë më i madh dhe më i rëndësishëm, në fokusin kryesor të Rosisë.

Rusia duket se ka grumbulluar shumë trupa ushtarake përgjatë kufirit me Ukrainën. Nëse synimi është pushtimi i Ukrainës, nuk mjafton vetëm mposhtja e ushtrisë ukrainase, por ushtria ruse mund të pushtojë fizikisht zona kyçe të këtij vendit. Por nëse raportet janë të vërteta, kjo është një lojë e rrezikshme.

Plani i luftës i Rosisë është padyshim sekret. Por qeveria ukrainase ka bërë publike pikëpamjen e saj se si do të

ndodhte një pushtim rus. Plani përbëhet nga 3 fronte kryesore sulmi që synojnë ta izolojnë dhe pushtojnë Kievin: në veri nga Bjellorusia, në jug nga Gadishulli i Krimesë, dhe në perëndim nga Volgograd.

Por kjo strategji ka 3 probleme. I pari është logjistik. Këto forca me shumë divizione do të angazhoheshin në manovra dhe luftime me një intensitet të lartë. Të tria frontet do të duhet që të furnizohen në vijimësi, dhe ndërsa i afrohen Kievit, ato do të merrnin formën e një rrethi. Meqë duhet të supozohet se luftimet intensifikohen me zvogëlimin e avancimit, njëra nga fazat do të kërkonte sasi të madhe të karburanteve.

Faza e dytë do të kërkonte sasi të mëdha municionesh të të gjitha llojeve. Ekziston mundësia e ndërprerjeve të pakoordinuara të përparimit, duke lënë zbuluar krahët e ushtrisë ruse. Problemi i dytë është se kjo strategji do të krijonte një luftë të ndërlikuar, me shumë fronte, dhe të zhvilluar nga trupa që nuk kanë përvojë. Rusët nuk kanë zhvilluar një betejë me kaq shumë divizione që nga Lufta e Dytë Botërore. Ushtria e tyre është kompetente, por asnjë nga komandantët e tyre nuk e ka komanduar në këtë lloj betejë.

Lojërat dhe manovrat luftarake vlejné në parim, por një forcë e paprovuar nën zjarr, ka nevojë për një strukturë komanduese shumë të sofistikuar. Dhe rusët nuk do ta dinë nëse e kanë një të tillë, derisa ta provojnë këtë në praktikë.

Problemi i tretë janë amerikanët, të cilët nuk do të përipien me gjasë të bllokojnë avancimin me

trupat e tyre. Koha është thelbësore, por imponimi i “fërkimit” ndaj një armiku është i vlefshëm në vetvete. Për shembull SHBA-ja është në gjendje të transportojë forcat polake, për të krijuar atë fërkim. (Gjithnjë duke supozuar se polakët janë të gatshëm ta bëjnë këtë).

Por nëse do të zgjidhte të dërgonte trupat e veta, SHBA-ja do ta detyronte Rusinë të angazhohej në luftime në shkallë të plotë, sipas një plani për të cilin nuk ishte përgatitur. Por kërcënimet më të rëndësishëm nga amerikanët, do të ishte fuqia ajrore dhe raketore. Objektivat e tyre do të ishin nyjet logjistike.

Në luftën e blinduar, siç duket që është edhe plani, shkatërrimi i rezervave të karburantit dhe municioneve është i njëjtë me shkatërrimin e tankeve. Rusëve do t’u duhet që ta parandalojnë këtë duke neutralizuar bazat ajrore dhe raketore të SHBA-së, me shumë mundësi në shkallë globale.

Por që ta ndodhë kjo, Rusia duhet që ta përshkallëzonte luftën në statusin e një lufte botërore, dhe në atë pikë rreziqet për Rusinë do të ishin shumë të mëdha. Shtetet e Bashkuara e njohin kërcënimin rus, ose të paktën duan që Rusia të besojë se e ka njohur atë. Deklaratat e presidentit Bajden mbi këtë çështje, nënkuptojnë një nivel shqetësimi, i cili sugjeron se nëse Rusia sulmon Ukrainën, do të kishte një ndërhyrje të SHBA-së.

Nëse Rusia synon që të pushtojë Ukrainën, do të nevojiten disa ndryshime. Por të realizuar një të tillë, ajo mund të ketë nevojë

vetëm për aneksimin e një pjese të Ukrainës në lindje ose në veri. E interesuar të shmangë një luftë në mesin e Euroazisë, kur kërcënimet është i parëndësishëm, SHBA-ja ka të ngjarë të kundërpërgjigjet vetëm me sanksione.


Rusia mund ta përballojë këtë duke kërcënuar me zgjerimin e pushtimit, por pa e kryer këtë të fundit. Kjo e ndryshon dinamikën politike në Evropë, e paaftë për të ngritur vetë një linjë mbrojtëse, do të zgjedhë të zbusë tonet me Rusinë. Sigurisht, i gjithë kërcënimet mund të jetë thjesht një përpjekje për të testuar Bajdenin.

Gjatë Luftës së Ftohtë, testimi i presidentit të ri të SHBA-së, ishte një rutinë e sovjetikëve. Por bërja e këtij testi sot, mund të shihet si një veprimtari me rrezikshmëri të ulët, dhe me përfitime të mëdha. Në fakt, ka shumë kundër argumente mbi pikëpamjen time, se një pushtim i plotë i Ukrainës është shumë kompleks dhe i rrezikshëm për t’u ndërmarrë.

Rusët nuk kanë luksin të përballojnë një humbje, në përpjekjen e tyre për të siguruar Ukrainën në realitetin aktual gjeopolitik. Ata kanë kohë për të lëvizur. Por kjo vetëm nëse Putin, që është i interesuar të ri-caktojë kufirin, është i përgatitur të rrezikojë për hir të lavdisë personale. Ndoshta kjo mund të jetë e vërtetë, por njerëzit e KGB-së janë të trajnuar të jenë të kujdesshëm. Basti im është se ky është një bllof. Por gjithsesi për këtë çështje, unë nuk do të vija në bast shtëpinë time.

“Geopolitical Futures” – Bota.al





QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Gjimshiti: Do të luftojmë për çdo pikë



**TIRANË, 20 DHJETOR** - Kombëtarja e Shqipërisë është njohur tashmë prej disa ditësh me rivalët që do të ketë përballë në edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve (Nations League), me ndeshjet që nisin në fillim të muajit qershor.

Shqipëria është në Grupin 2 të Ligës B të këtij kompeticioni së bashku me Rusinë, Islandën dhe Izraelin.

Përfaqësuesja shqiptare do ta ketë mundësinë të zhvillojë miqësore në muajin mars për t'u përgatitur për turneun e UEFA-s, ndërkohë që rivalët mbeten ende për t'u përcaktuar. Në

lidhje me shortin ka folur edhe Berat Gjimshiti, një nga shtyllat e mbrojtjes kuqezi dhe ekipit kombëtar. Në prononcimin e tij për "Fshf.org", mbrojtësi është shprehur se rivalët që do të ketë përballë Shqipëria janë të fortë dhe është i bindur se ekipi do të dhurojë ndeshje të bukura ndaj kundërshtarëve të këtij niveli.

Gjithashtu, Gjimshiti ka theksuar se objektivat duhen përcaktuar me kalimin e kohës, teksa ka shtuar se kombëtarja shqiptare do të luftojë për çdo pikë në fushë dhe do t'u tregojë të gjithëve se është në rritje të vazhdueshme. "Për mendimin tim, shorti i

Nations League më duket i vështirë për Shqipërinë, në të njëjtën kohë do të na dhurojë emocione mjaft të bukura sa iu përket sfidave që do të kemi, duke u përballur me këto skuadra që janë shumë të forta", ka thënë Gjimshiti, duke shtuar se do të luftojnë për çdo pikë. "Sigurisht, objektivat duhet t'i përcaktojmë me kalimin e kohës, por është e rëndësishme që ne të tregojmë se do të luftojmë për çdo pikë në këtë grup dhe t'i tregojmë vlerat tona, edhe ta konfirmojmë edhe një herë rritjen e kombëtares shqiptare në kohën e fundit", ka thënë Gjimshiti.

## Muriqi, në mes të Fenerbahçes dhe Galatasarayt

**ROMË, 20 DHJETOR** - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi, do të largohet nga Lazio dhe në janar pritet të rikthehet në Turqi. Dy gjigantët nga Stambolli janë në garë për 27-vjeçarin. Ylli i Kosovës nuk ka arritur të bindë me kualitetet e tij në kryeqytetin italian. Ai i ka realizuar vetëm dy gola për një vit e gjysmë. Prandaj, "Biancocelesti" ka vendosur ta shesë prizrenasin në afatin kalimtar të janarit. Për përfaqësuesin e Kosovës, të gjitha

rrugët çojnë kah Turqia. Për të, interesim ka shfaqur ish-klubi i tij, Fenerbahçe, edhe gjiganti tjetër nga Stambolli, Galatasaray.

Më i mundshëm është rikthimi i Muriqit në klubin "verdh e kaltër", aty ku e ka arritur kulmin e karrierës. Sidoqoftë, nuk përjashtohet mundësia që ai të përfundojë në Galatasaray, pasi Lazio e pëlqen mbrojtësin e majtë të këtij ekipi, Patrick John Miguel van Aanholt. Andaj,

Muriqi do të mund të shkëmbejë pikërisht me mbrojtësin e majtë holandez. 27-vjeçari nuk ka arritur kurrë t'i bindë drejtuesit e Lazios. Atij i është dhënë rasti disa herë, por nuk ka ditur ta shfrytëzonte. Prandaj, Muriqi i ka bërë valixhet gati dhe pritet të largohet nga Italia në fillim të janarit. Futbollisti nga Kosova i kishte kushtuar Lazios rreth 20 milionë euro dhe ai kishte nënshkruar kontratë deri në vitin 2025.



## Benzema drejt ribashkimit me Zidanen te PSG-ja



**PARIS, 20 DHJETOR** - Ish-trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, mund të bashkohet me sulmuesin Karim Benzema te PSG-ja gjatë verës së ardhshme. Klubi i Ligës 1 është duke u përgatitur për kohën pa Kylian Mbappe dhe trajnerin Mauricio Pochettino që pritet të largohen në verë nga "Parku i princave". Me Didier Deschamps që është në krye të kombëtares së Francës, Zidane besohet të jetë

kandidati kryesor për ta zëvendësuar Pochettinon, derisa tekniku argjentinas pritet ta marrë drejtimin e Manchester Unitedit. Sipas "Le10Sport", PSG e ka identifikuar Benzeman si zëvendësuesi i Mbappes, që i skadon kontrata në vitin 2022. Raporti ka theksuar se 34-vjeçari pastaj do të ishte çelësi për ardhjen e Zidane, që kuptohet se dëshiron të punojë

me sulmuesin sërish dhe mbrojtësin Sergio Ramos që u transferua te PSG-ja verën e kaluar.

Benzema ishte një ndër lojtarët kyç të Zidanës gjatë kohës në "Santiago Bernabeu", me të cilin arritën të fitojnë tri herë radhazi Ligën e Kampionëve. Francezi ka realizuar 297 gola në 581 paraqitje për "Los Blancos", duke përfshirë 18 në 22 paraqitje këtë edicion.

## Manchester Unitedi nuk pranon asnjë ofertë për Pogban

**MANCHESTER, 20 DHJETOR** - Manchester Unitedi nuk ka marrë ndonjë ofertë për mesfushorin Paul Pogba para afatit kalimtar dimëror. 28-vjeçari ka edhe gjashtë muaj kontratë të mbetur në "Old Trafford" dhe shenjat tregojnë se nuk do ta rinovojë kontratën, përcjell "lajmi.net". Sipas

"Manchester Evening News", trajneri i përkohshëm Ralf Rangnick është gati ta lejojë Pogban të largohet gjatë dimrit, por "Djajtë e Kuq" ende nuk kanë pranuar ndonjë ofertë serioze për francezin. Man. United nuk ishte në gjendje të transferonte qendër-mesfushorin në verë ngaqë vendosi të ketë

prioritet transferimet si Jadon Sancho, Raphael Varane dhe Cristiano Ronaldo, duke shpenzuar me 100 milionë euro në proces. Man. United ishte i interesuar për yllin e West Hamit, Declan Rice dhe atë të Rennes, Eduardo Camavinga (tani lojtar i Real Madridit), por dështoi t'i transferonte shkaku i gjendjes financiare.







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit administrativ 05/2021, Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe kërkesave të Qendrës Burimore, Departamenti i arsimit parauniversitar, shpall;

## KONKURS

Për vendin e lirë të punës në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” Prizren

Nr.	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitave
1	Mësimdhënës/e e gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët në QB “Nënë Tereza” në Prizren ( rishpallur)	vend i lirë	1
2	Instruktur/e të gjuhës së shenjave në QB “Nënë Tereza” në Prizren	vend i lirë	1

### I. Punët dhe detyrat kryesore për mësimdhënës/e të gjuhës shqipe:

- I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë;
- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor dhe javor të punës arsimore dhe edukative;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve;
- Përdor shkathtësi specifike për mësimdhënie në gjuhën e shenjave për nxënësit me dëmtime në dëgjim.

#### 1. Përgatitja shkollore për mësimdhënës të gjuhës shqipe:

- Niveli master –arsimor- Fakulteti Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelori (katërvjeçar 240 ECTS).

### II. Punët dhe detyrat kryesore të Instrukturit/es së gjuhës së shenjave

- Mbështet nxënësit dhe stafin e QB për gjuhën e shenjave;
- Ofron kurse të gjuhës së shenjave për stafin e QB dhe prindërit e nxënësve;
- Bashkëpunon me menaxherin dhe stafin e QB në promovimin e gjuhës së shenjave;
- Në bashkëpunim me stafin harton materiale për QB në gjuhën e shenjave.

#### 2. Përgatitja shkollore për Instruktur të gjuhës së shenjave

- Niveli bachelori – trajnimi për gjuhën e shenjave me 120 kredi (ECTS).

#### Kushtet e konkursit

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit: paragrafi 5 i nenit 35 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, paragrafi 1 i nenit 6, paragrafi 7 i nenit 8 të Udhëzimit administrativ 05/2021 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

**Sqarim shtesë:** – Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuar dokumentet në MASHTI.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës.

Për mësimdhënës përvojë e punës në procesin edukativ – arsimor 3 vite.

Njohja e gjuhës së shenjave e dëshirueshme.

#### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik. Formulari i aplikimit ( merret në Qendër Burimore).

Dokumenti personal ( letërnjoftim ose pasaportë).

Diploma e kualifikimit (ose certifikatë) certifikata në vend të diplomës duhet të jetë e noterizuar.

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore/shkollën speciale përkatëse ku konkurrojnë. Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Na osnovu člana 67. i 68. Zakona br. 06 / L-114 o javnim službenicima, član 8, stav 1 i 2 Zakona o radu br. 03 / L-212, (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 90/2010), Zakon br. 04 / L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, Administrativno uputstvo 05/2021, Administrativno uputstvo br. 02/2018 za Resursne centre, Administrativno uputstvo br. 07/2017, o Urejenju konkursnim procedurama u javnom sektoru i zahtevima Resursna centra, Departament za preduniverzitetsko obrazovanje objavljuje

## KONKURS

Za slobodna radna mesta u Resursnom centru za nastavu i savetovanje „Majka Tereza“ Prizren

Br.	Pozicija	Slobodno radno mesto/zamena	Br. pozicije
1	Profesor albanskog jezika u nižem srednjem obrazovanju u RC „Majka Tereza“ u Prizrenu (ponovno najavljeno)	slobodno mesto	1
2	Instruktur znakovnog jezika u RC „Majka Tereza“ u Prizrenu	slobodno mesto	1

### I. Glavni poslovi i zadaci nastavnika/ce albanskog jezika:

- Ostvaruje ciljeve i zadatke osnovnog, nižeg srednjeg i višeg srednjeg obrazovanja;
- Planira i sprovodi godišnji, mesečni i nedeljni plan obrazovno i vaspitnog rada;
- Koristi savremene nastavne metode i tehnike vodeći računa o individualnim potrebama učenika;
- Koristi specifične veštine za nastavu znakovnog jezika za učenike sa oštećenim sluhom.

### 1. Školska sprema za nastavnika albanskog jezika:

- Nivo-obrazovanja Edukativni fakultet (300 ECTS);
- Četvorogodišnje sistem;
- Bachelor (četvorogodišnji 240 ECTS).

### I. Glavni poslovi i zadaci Instruktor/ke znakovnog jezika

- Podržava učenike i osoblje RC za znakovni jezik;
- Pruža kurseve znakovnog jezika za osoblje RC i roditelje učenika;
- Saraduje sa menadžerem RC i osobljem u promovisanju znakovnog jezika;
- U saradnji sa osobljem sastavlja materijale za RC na znakovnom jeziku.

### 2. Školska sprema za instruktora znakovnog jezika

- Nivo bachelori – obuka za znakovni jezik sa 120 kredita (ECTS).

#### Uslovi konkursa

Izbor kandidata vrši se na osnovu kriterijuma zakona koji regulišu oblast obrazovanja: stav 5. člana 35. Zakona br. 04 / L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, stav 1 člana 6, stav 7 člana 8 Administrativnog uputstva 05/2021 o normativu o stručnom osoblju opšteg obrazovanja.

**Dodatno pojašnjenje:** - Podaci navedeni u prijavi smatraju se validnim samo ako su dokazani dokumentima.

Lica koja su diplomirala van Kosova moraju imati nostrifikovana dokumenta u MONTI-u.

Na pismenom intervju će biti pozvani kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.

Kandidati koji se prijavljuju moraju biti stanovnici Republike Kosovo.

Za nastavnike radno iskustvo u edukativno-obrazovnom procesu 3 godine.

Poželjno poznavanje znakovnog jezika..

#### Rok i način prijavljivanja

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja konkursa u sredstvima javnog informisanja.

Formular za prijavljivanje (dobija se u Resursnom centru).

Lični dokument (lična karta ili pasoš).

Kvalifikaciona diploma (ili uverenje) Uverenje umesto diplome mora biti overeno kod notara.

Kandidati moraju dostaviti dokumente Resursnom centru / relevantnoj specijalnoj školi u kojoj konkuriše. Nepotpune prijave se ne razmatraju.





Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada-Government  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:1220/1  
 Dt:20.12.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndet teorike dhe praktike në profilin: Instalues elektrik (20 orë mësimore)	Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimin e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysnë, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Zhuri" Sh.p.k. Prizren, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit të tipit 'Elkon' në Petrovë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.01.2022 në ora 10:00 në Hapsirat e kompanisë „Zhuri” Shpk në Petrovë komuna e Prizrenit do të organizohet debat publik nga Kompania "Zhuri" Sh.p.k. Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën për prodhimin e betonit të tipit 'Elkon' në Petrovë, Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcKxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Zhuri" Sh.p.k. Prizren, për bazën për bazën për prodhimin e betonit të tipit 'Elkon' në Petrovë, Prizren.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
 KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

### FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës:  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit: 10-21

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Institutit A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishrinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: **Kontrat për furnizim me faksimil**

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

### Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: 31.12.2021 ora 14:00.

Afati i fundit për aplikim në Tender është: 05.01.2022 ora 12:00.

Hapja e ofertave bëhet me datën: 05.01.2022 ora 14:00.



**GJIMNAZI "XHEVDET DODA"**

Prishtinë, 20.12.2021

Nr.P.563/2021

Në mbështetje të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Prishtinës - 01.Nr.110-157460, të dt.01.07.2014, për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, Këshilli Drejtues i Shkollës me 26.11.2021 mori vendim (nr.p.538/2021, dt.26.11.2021) për dhënjën e hapësirës shkollore me qira, për hapjen e një Kantine për nxënës dhe mësimdhënës.

**FTESË PËR OFERTIM****Për**

Ofrimi i Shërbimeve të bufesë për objektin e shkollës Gjimnazi "Xhevdet Doda" në hapsirën e destinuar sipas projektit të shkollës.

Ftesat për ofertim mund të tërhiqen në adresën e më poshtme nga data e publikimit të ofertës deri me 30.12.2021

Gjimnazi "Xhevdet Doda": rr."Xhevdet Doda" nr.60

Qyteti: PRISHTINË

Adresa Elektronike: [xh.doda1971@gmail.com](mailto:xh.doda1971@gmail.com)

Personi Kontaktues: Sekretarja e Shkollës

E-mail: [xh.doda1971@gmail.com](mailto:xh.doda1971@gmail.com)

Telefoni: 038 613 444

Nga: KDSH

Rruga: "Xhevdet Doda" Nr.60, Prishtinë - Kosovë  
E-mail: [shml.xhevdet.doda@rks-gov.net](mailto:shml.xhevdet.doda@rks-gov.net)  
Nr.tel: +383 (0) 38 613444

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Dyqani i pavarur hotelier "Biljardo Club" me numër fiskal: 600376265, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

